



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**RREGULLORE (ZKM) NR. 19/2024 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM
DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË AGJENCISË
KOSOVARE PËR STANDARDIZIM¹**

¹ Rregullorja (ZKM) - Nr. 19/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë Kosovare për Standardizim, është miratuar nga Kryeministri me Vendimin Nr. 187/2024, të datës 15.11.2024

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 (paragrafi 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 28 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, nenit 9 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 17/2024 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe nenit 9 paragrafi 7 të Rregullores Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura:

Miraton:

**RREGULLORE (ZKM) NR. 19/2024 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE
SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË AGJENCISË KOSOVARE PËR
STANDARDIZIM**

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencisë Kosovare për Standardizim në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (tutje “Agjencia”).

**Neni 2
Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet për Agjencinë Kosovare për Standardizim, kompetencat e përgjithshme për fushën e standardizimit përcaktohen me Ligjin përkatës për standardizim si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

KAPITULLI II

ORGANIZIMI I BRENDSHËM NË AGJENCINË KOSOVARE PËR STANDARDIZIM

Neni 3

Misioni i Agjencisë Kosovare për Standardizim

Misioni i Agjencisë Kosovare për Standardizim është zhvillimi, adoptimi dhe miratimi i standardeve dhe stimulimin e fuqishëm të zhvillimit ekonomik, duke krijuar bazë për konkurrencë në rajon dhe më gjerë. Është një ndër komponentët kryesore të infrastrukturës së cilësisë, e cila siguron platformë për zhvillimin e standardizimit, duke mbështetur sigurinë dhe cilësinë e produkteve, proceseve dhe shërbimeve përmes standardeve.

Neni 4

Struktura Organizative e Agjencisë Kosovare për Standardizim

1. Struktura Organizative e Agjencisë Kosovare për Standardizim është si vijon:
 - 1.1. Drejtori Ekzekutiv;
 - 1.2. Divizionet.
2. Numri i të punësuarve në Agjencinë Kosovare për Standardizim është njëzetë (20).
3. Shërbimet e përgjithshme do të kryhen nga dikasteret përkatëse të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Neni 5

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare për Standardizim përbëhet nga:
 - 1.1. Drejtori Ekzekutiv;
 - 1.2. Një (1) Asistente Administrative.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen me Ligjin përkatës për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura dhe Ligjin përkatës për standardizim si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Administrativ të Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv, përcaktohen sipas legjislacionit përkatës për Zyrtarët Publikë.

4. Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv është dy (2).

Neni 6
Divizionet në
Agjencinë Kosovare për Standardizim

1. Agjencia përbëhet nga këto divizione:

- 1.1. Divizioni për Standarde;
- 1.2. Divizioni për Promovimin e Standardeve dhe Integrimin në Organizatat e Standardizimit;
- 1.3. Divizioni për Aftësim dhe Çertifikim me Standarde.

Neni 7
Divizioni për Standarde

1. Misioni i Divizionit për Standarde është zhvillimi, adoptimi dhe miratimi i standardeve kosovare që konsiston më nevojat që kanë ndërmarrjet prodhuese dhe të shërbimit, pavarësisht nga forma dhe madhësia e tyre, bizneset, qeveria dhe konsumatorët për t'i siguruar atyre qasje në standarde, të cilat plotësojnë nevojat e tyre për cilësi dhe aftësi konkurruese më të madhe. Mbështet punën e këshillit profesional të standardizimit si dhe komiteteve teknike, në zbatimin e politikave dhe procedurave të standardizimit, mbështet notifikimin e standardeve në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit si dhe në organizatat tjera që kanë të bëjnë me standarde.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizioni për Standarde janë:

- 2.1.Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e standardizimit;
- 2.2.Menaxhimi i aktiviteteve për adoptimin e standardeve dhe ngritja e nivelit cilësor dhe teknik të tyre;
- 2.3.Hartimi, adoptimi dhe miratimi i standardeve kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare si standarde kosovare, me prioritet hartimin e atyre standardeve për të cilat ka më shumë nevojë industria dhe ekonomia kosovare dhe që ndihmojnë në eliminimin e barrierave teknike në lëvizjen e lirë të mallrave, proceseve dhe shërbimeve.
- 2.4.Organizimi, përditësimi, shfuqizimi dhe administrimi i standardeve;
- 2.5.Identifikimi i standardeve sipas kërkesave të palëve të interesit;
- 2.6.Mirëmbajtja dhe konfirmimi periodik i statusit të standardeve;
- 2.7.Menaxhimi i aktiviteteve tjera të lidhura me standarde të përcaktuara me ligjin përkatës për standardizim.
- 2.8.Notifikimi i standardeve në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit si dhe në organizatat tjera që kanë të bëjnë me standarde;

2.9.Ndërlidh punën e Komiteteve Teknike Kosovare me Komitetet Teknike homologe evropaine dhe ndërkombëtare.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Standarde, raporton tek Drejtori Ekzekutiv i AKS.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Standarde është tetë (8).

Neni 8

Divizioni për Promovimin e Standardeve dhe Integrimin në Organizatat e Standardizimit

1. Misioni i Divizionit për Promovimin e Standardeve dhe Integrimin në Organizatat e Standardizimit është zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e standardizimit, të koordinojë dhe të promovojë efikasitetin e standardizimit përmes koordinimit të bashkëpunimit me ndërmarrjet prodhuese dhe të shërbimit dhe institucioneve vendore, kontakte me organizata ndërkombëtare për ngritje të nivelit të bashkëpunimit në fushën e standardeve, digjitalizimin e standardizimit etj. Nëpërmjet aktiviteteve promovuese, Divizioni, promovon ndërgjegjësimin e publikut dhe të grupimeve të interesit për rëndësinë e aplikimit të standardeve, të cilat ndihmojnë për të harmonizuar specifikimet teknike të produkteve dhe shërbimeve duke e bërë industrinë më efikase, për të përmirësuar sigurinë dhe për të rritur cilësinë, të cilat janë mjeti bazë për reduktimin e barrierave në tregtinë ndërkombëtare si dhe përhapjen e njohurive përmes standardeve tek të gjitha palët e interesit.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Promovimin e Standardeve dhe Integrimin në Organizatat e Standardizimit janë:
 - 2.1. Organizon fushata promovuese për standarde dhe standardizimin në qendrat rajonale dhe më gjerë me qëllim të sensibilizimit të rëndësisë së standardeve;
 - 2.2. Shitja dhe marketingu i standardeve, si dhe ofrimi i shërbimeve për palët e interesit;
 - 2.3. Ofrimi i mbështetjes së punës të komiteteve teknike me institucione relevante;
 - 2.4. Funksionalizimi dhe administrimi i standardeve në data bazë dhe arkivimi i tyre;
 - 2.5. Mirëmbajtja e qendrës së informacionit për standarde;
 - 2.6. Inicimi i studimeve, publikimeve, përvojës së punës kërkimore dhe aktiviteteve tjera të ndërlidhura me standardizimin;
 - 2.7. Publikimi i buletinit, katalogut vjetor me standarde kosovare si dhe materiale tjera promovuese për standardizimin;
 - 2.8. Mbikëqyrë dhe ndihmonë në zhvillimin e sistemit të bazës së të dhënave me standarde në raport me bazat e të dhënave nga CEN, CLC, ISO, IEC dhe ETSI si dhe avancim me teknologji në hap me këkresat e standardizimit, digjitalizimi i shërbimeve të standardizimit dhe arkivimi i tyre. (data baza SMIS (Sistemet për Menaxhimin e Informacioneve për Standarde); e-kosova (shërbimi i shitjes së standardeve); ueb faqja; rrjetet sociale; etj.);

- 2.9. Menaxhimi i aktiviteteve tjera të lidhura me promovimin e standardeve dhe standardizimit dhe integrim në Organizatat e Standardizimit të përcaktuara me ligjin përkatës për standardizim.
 - 2.10. Koordinon dhe siguron zbatimin e aktiviteteve, monitoron dhe raporton për zbatimin e detyrimeve që dalin nga marrveshjet dhe detyrimet ndërkombëtare sa i përket standardizimit, procesi i avancimit të bashkëpunimit, mbrojtjes së të dhënave dhe çështjeve tjera ligjore.
3. Udhëheqësi i Divizionit për Promovimin e Standardeve dhe Integrimin në Organizatat e Standardizimit raporton tek Drejtori Ekzekutiv i AKS-së.
 4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Promovimin e Standardeve dhe Integrimin në Organizatat e Standardizimit është pesë (5).

Neni 9

Divizioni për Aftësim dhe Çertifikim me Standarde

1. Misioni i Divizionit për Aftësim dhe Çertifikim me Standarde, është të kryejë aftësim me dhe për standarde europiane dhe ndërkombetare, të kryej certifikime dhe vlerësime regjistrimi gjithëpërfshirëse dhe të pavarura për organizatat prodhuese dhe të shërbimit, në mënyrë që t'u ofrojë klientëve dëshmi të pajtueshmërisë me standardet, ku në kontekstin e tregtisë së drejtë, organet certifikuese vlerësojnë nëse një produkt ose një kompani i përmbahet standardeve të tregtisë së drejtë, të cilat përfshijnë kritere mjedisore, sociale dhe ekonomike
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizioni për Aftësim dhe Çertifikim me Standarde përcaktohen sipas dispozitave të Ligjit për zyrtarë publikë dhe Standardeve Evropiane dhe Nderkombetare.
 - 2.1. Harton dhe rishikon specifikimet për produktet ose proceset.
 - 2.2. Përcaktonë kriteret e certifikimit dhe proceset që duhen ndjekur për të qenë në përputhje me rregullat dhe kërkesat e standardeve.
 - 2.3. Siguron respektimin e udhëzimeve për shëndetin dhe sigurinë, si dhe detyrimet ligjore.
 - 2.4. Kryen mbikëqyrjen teknike, mbikëqyrjen të personelit si dhe jep udhëzime dhe këshilla.
 - 2.5. Mbikëqyr të gjitha procedurat e zhvillimit të ndërmajres për të identifikuar devijimet nga standardet e cilësisë.
 - 2.6. Aplikon standadin dhe mirëmban sistemin e manualit të cilësisë në AKS.
 - 2.7. Analizon nevojat dhe kërkesat e klientëve për të zhvilluar procese efektive të menaxhimit të cilësisë.
 - 2.8. Ofron shërbimin e aftësimin për standardet europiane dhe ndërkombetare në veçanti standardet për sistemet e menaxhimit të cilësisë.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Aftësim dhe Çertifikim me Standarde raporton tek Drejtori Ekzekutiv i AKS-së.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Aftësim dhe Çertifikim me Standarde është pesë (5).

KAPITULLI III

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE SHFUQIZUESE

Neni 10

Dispozita kalimtare

1. Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit nuk krijon nevojë për plotësim ndryshimin e kësaj Rregulloreje, përpos në rastet kur krijohen dhe/apo shuhen strukturat organizative.
2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, dispozitat e ligjit vjetor të buxhetit janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 11

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen nenet 60 deri 64 të Rregullores nr. 29/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 12

Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryeministri i Republikës së Kosovës.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

15/11/2024

**Organogrami i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Agjencia Kosovare për Standardizim (AKS)**

Pozicioni/Struktura	Klasa	Grupi (i përgjithshëm ose i veçant)	Numri
1. Drejtori Ekzekutiv	Drejtues/e i/e Lartë		1
<ul style="list-style-type: none"> • Asistent/e Administrativ 	Profesional 3	64. Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
- Udhëheqës i Divizionit për Standarde	Drejtues/e i/e Ulët/		1
<ul style="list-style-type: none"> • Zyrtar I lartë për standarde • Zyrtar I lartë për notifikim të standardeve 	Profesional 1 Profesional 1	3. Grupi i ekonomisë 3. Grupi i ekonomisë	6 1
-Udhëheqës i Divizionit për Promovimin e Standardeve dhe Integrimin në Organizatat e Standardizimit	Drejtues/e i/e Ulët/		1
<ul style="list-style-type: none"> • Zyrtar/e i Lartë për promovimin e standardeve dhe informim • Zyrtar/e I Lartë për antarësim në organizatat e standardizimit • Zyrtar/e I lartë i teknologjisë informative • Zyrtar/e I lartë për shitje të standardeve 	Profesional 1 Profesional 1 Profesional 1 Profesional 1	8. Grupi i marrëdhënieve me publikun dhe informim 1. Grupi ligjor 50. Grupi i teknologjisë së të dhënave 3. Grupi i ekonomisë	1 1 1 1
Udhëheqës i Divizioni për Aftësim dhe Çertifikim me Standarde	Drejtues/e i/e Ulët/		1
<ul style="list-style-type: none"> • Zyrtar/e i Lartë për Aftësim dhe Certifikim me Standarde Industriale Zyrtar/e i Lartë për Aftësim dhe Certifikim me Standarde të Ndërtimit 	Specialist/ Specialist	33. Grupi i inxhinierisë industriale/ Industrial engineering group 34. Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	2 2
			Totali: 20

